


**MEMORANDUM I BASHKËPUNIMIT
NDËRMJET
REPUBLIKËS SË TURQISË
ZYRA E KRYEMINISTRIT
AGJENCIA TURKE PËR BASHKËPUNIM DHE KOORDINIM
DHE
REPUBLIKËS SË KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT
DHE
KOMUNËS SË GJAKOVËS
PËR RESTAURIMIN E MEJTEPI RUZHDIJES NË GJAKOVË**



**Neni 1:
PALËT**

Me qëllim të zhvillimit të bashkëpunimit reciprok në fushën e kulturës dhe trashëgimisë kulturore, në frymën e miqësisë ndërmjet dy shteteve, duke u bazuar në dispozitat e “Protokollit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë për Bashkëpunimin dhe zhvillimin dhe për Statusin e Programit të Zyrës Koordinuese të Agjencisë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim”, e nënshkruar më 02 Shkurt 2010 në Ankara, nënshkruhet Memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Turqisë, Zyra e Kryeministrit, Agjencisë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (në tekstin e mëtejme “TIKA”), Republikës së Kosovës, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (në tekstin e mëtejme “MKRS”) dhe Komunës së Gjakovës (në tekstin e mëtejme “Komuna”) (në tekstin e mëtejme “Palët” ose “Pala”).

**Neni 2:
QËLLIMI**

Qëllimi i këtij Memorandumi është zhvillimi i bashkëpunimit reciprok në fushën e trashëgimisë kulturore, përkatësisht përcaktimi i parimeve të bashkëpunimit dhe obligimeve të palëve në kuadër të “Projektit për Restaurim të Mejtepit Ruzhdije në Gjakovë”.

OBLIGIMET E PALËVE

Neni 3

OBLIGIMET E TIKA-SË

Obligimet e TIKA-së janë si më poshtë:

- Të sigurojë projektin zbatues për restaurim të Mejtepit Ruzhdije në Gjakovës dhe të dërgojë për shqyrtim dhe aprovim në Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve (IKMM);
- Procedurat e prokurimit dhe tenderimit të projektit zbatuesi cili do të aprovohet nga palët, do të realizohet sipas ligjeve dhe rregulloreve të zbatuara nga ana e TIKA-së, si dhe kontrata me kontraktuesin (punë kryesin) do të nënshkruhet nga TIKA;
- Të sigurojë financimin dhe mbështetjen materiale për zbatimin e projektit të aprovuar nga palët;

- d) Të sigurojë që zbatimi dhe mbikëqyrja e projektit të kryhet në përputhshmëri me standardet më të larta profesionale nga stafi adekuat profesional si dhe nga kompanitë profesionale;
- e) Të sigurojë që gjatë kohëzgjatjes së projektit të emërojë organin mbikëqyrës i cili do të përbëhet nga ekspertet e fushës së restaurimit nga Turqia si dhe të emërojë 1 (një) koordinator të projektit;
- f) Të sigurojë që punët restauruese të zbatohen me metoda shkencore duke përdorur teknikat bashkëkohore të restaurimit dhe duke vlerësuar me kriter shkencore çdo periudhë që objekti ka kaluar.
- g) Të lajmëroj institucionet përkatëse respektivisht palët nënshkruese të këtij memorandumit për fillimin e punimeve , 1 jave me herët.

OBLIGIMET E MKRS-SË

Obligimet e MKRS-së janë si më poshtë:

- a) Të sigurojë që faza e hartimit dhe zbatimit të projektit, të bëhet në bashkëpunim dhe koordinim të plotë në mes Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturorë (QRTK)-Gjakovë dhe TIKÀ-së, si dhe sipas kërkesës së TIKÀ-së, QRTK-Gjakovë të ofrojë dhe të sigurojë informata dhe dokumentet e nevojshme për projektin;
- b) Të sigurojë që projekti zbatues i restaurimit të Mejtepit Ruzhdiqe në Gjakovës, i cili do të hartohet dhe dorëzohet nga ana e TIKÀ-së, të aprovohet në Komisionin e IKMM-së brenda 15 ditë pune, prej datës së pranimi të projektit;
- c) Të sigurojë të gjitha lejet (lejet komunale, lejet nga pronari i pronës dhe lejet e tjera të nevojshme nga institucionet relevante) të nevojshme për fazën e zbatimit të projektit;
- d) Të sigurojë që gjatë kohëzgjatjes së projektit të emërojë organin mbikëqyrës i cili do të përbëhet nga ekspertet e fushës së restaurimit;
- e) Të ofroj mbështetjen dhe ndihmën e nevojshme për TIKÀ-në, në procesin e zbatimit të procedurave të lirimit nga taksa doganore dhe TVSH-në për mallrat e importuara nga Turqia ose vendet e tjera dhe lirimi nga TVSH-ja për mallrat e blera në Kosovë dhe të cilat do të përdoren në kuadër të zbatimit të projektit të Restaurimit.¹ Të ndihmojë në sigurimin e lejes së punës dhe lejeve të qëndrimit falas për stafin teknik të huaj të kontraktuesit (punë kryesit) e cila do të përcaktohet nga TIKÀ;

¹ Duke u bazuar në Nenin 4.4 të "Protokollit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë për Bashkëpunimin dhe zhvillimin dhe për Statusin e Programit të Zyrës Koordinuese të Agjencisë Turke Për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar - TIKÀ", e nënshkruar me 02 Shkurt 2010 në Ankara, zyra koordinuese e programit për Kosovë të TIKÀ-së, veç gëzon të drejtën e lirimit nga taksa doganore dhe TVSH për mallra të importuara dhe të blera në Kosovë me destinacion dhe përdorim në kuadër të projekteve, aktiviteteve dhe donacioneve në Kosovë;

OBLIGIMET E KOMUNËS

Obligimet e Komunës janë si më poshtë :

- a) Të sigurojë mbështetjen dhe ndihmën e nevojshme për zbatimin e punëve të restaurimit të Mejtepit Ruzhdije në Gjakovës;
- b) Të jap pëlqimin për fillimin e punimeve;
- c) Të bëjë dorëzimin dhe zbrazjen e ndërtesës për zbatimin e projektit.
- d) Të sigurojë që gjatë kohëzgjatjes së projektit të emërojë 1 (një) zyrtar për komunikim dhe koordinim.
- e) Të marrë vendimet e nevojshme në lidhje me përdorimin dhe destinimin e ndërtesës pas përfundimit të punëve restauruese në Mejtepin Ruzhdije në Gjakovës;

OBLIGIMET E PËRBASHKËTA

- a) Vendimet në lidhje me zgjidhjen e problemeve të mundshme rreth zbatimit të projektit do të merren nga TIKA, MKRS dhe Komuna;
- b) Punët e Konservim-Restaurimit do të zbatohen duke u respektuar Ligji i Trashëgimisë Kulturore dhe aktet tjera ligjore e nënligjore të Republikës së Kosovës në fushën e trashëgimisë kulturore dhe akteve tjera ligjore në fuqi;
- c) Pas mbarimit të punëve Restauruese nga ana e TIKA-së, ndërtesa do t'i dorëzohet Komunës;
- d) Palët në koordinim me TIKA-në gjatë zbatimit të projektit do të sigurojnë ndihmën e nevojshme në çdo fushë për organin mbikëqyrës dhe TIKA-në;
- e) Me hyrjen në fuqi të këtij Memorandumi palët do të njoftojnë njëra-tjetrën për informatat e personave kontaktues ose për ndryshimin e informatave e personave kontaktues;
- f) Palët pajtohen të mbajnë përgjegjësi të ndërsjella në zgjidhjen e pengesave subjektive dhe praktike në të gjitha temat të ndërlidhura me punën e ndërtesës në fjalë që të realizohet me sukses, kualitet të lartë dhe për një kohë sa më të shkurtër dhe në zgjidhjen e pengesave të tjera të pa parapara në këtë Memorandum.

Neni 4

KOHËZGJATJA DHE HYRJA NË FUQI

Ky Memorandum hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe mbetet në fuqi prej kësaj date deri në datën e përfundimit të punimeve, gjegjësisht në datën e kryerjes së pranimit teknik të punëve.

Neni 5:

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

- a) Në qoftë se gjatë fazës së hartimit të projektit zbatues nuk mund të tejkalohen mosëmarrëveshjet eventuale ndërmjet palëve, atëherë TIKA si financuese e projektit mund të tërhiqet nga Memorandumi;
- b) TIKA dhe Përfaqësuesit Komunal do të marrin vendim së bashku në lidhje me përdorimin dhe funksionimin e objektit pas përfundimit të punëve Restauruese në Ruzhdijen e Gjakovës;

V.R. KB 


- c) Palët, me shkrim mund të propozojnë për rishikimin apo plotësimin dhe ndryshimin e cilësdo dispozitë të këtij Memorandumi;
- d) Në rast të ndonjë kontesti lidhur me zbatimin ose interpretimin e këtij Memorandumi duhet të zgjidhet përmes konsultimeve dhe negociatave ndërmjet palëve;
- e) Ky Memorandum i përbërë prej 4 (katër) faqe dhe 5 Nene është hartuar në dy kopje origjinale në gjuhën Shqipe dhe në gjuhën Turke duke qenë i tërë teksti identik;
- f) Ky Memorandum është nënshkruar me datën **09/07/2018** në Gjakovë.

Në emër të Republikës së Turqisë
Zyra e Kryeministrit
Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe
Koordinim (TIKA)



Hasan Burak CERAN
Koordinator

Në emër të Republikës së Kosovës
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
(MKRS)



Veton FIRZI
Sekretar i Përgjithshëm

Në emër të Komunës së Gjakovës



Ardian GJINI
Kryetar